VENDIM
Nr. 55/2014

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT E KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

(Ndryshuar me vendim nr. 71/2015, datë 11.6.2015; nr. 108/2015, datë 21.12.2015; nr. 48/2016, datë 22.7.2016; nr. 10/2024, datë 25.1.2024)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 2, e 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, sipas lidhjeve nr. 1 e 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Vendimi nr. 40, datë 6.5.2013 i Kuvendit të Shqipërisë, shfuqizohet.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare më datë 1 shtator 2014.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 31.7.2014

Lidhja nr. 1

(Ndryshuar me vendim nr. 108/2015, datë 21.12.2015)



Lidhja nr. 2

(Ndryshuar me vendim nr.71/2015, datë 11.6.2015; nr. 108/2015, datë 21.12.2015; nr. 48/2016, datë 22.7.2016; nr. 10/2024, datë 25.1.2024)

ORGANIKA DHE NUMRI I PUNONJËSVE TË INSPEKTORATIT DEKLARIMIT E KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Funksioni	Nr. i punonjësve	Kategoria/klasa
I. Inspektori i Përgjithshëm	1	Ligji nr.34/2023, datë 25.5.2023
II. Kabineti		
Drejtor Kabineti	1	I-3
Këshilltar	1	I-4
Sekretar i Inspektorit të Përgjithshëm	1	VKM nr. 325, datë 31.5.2023
III. Sekretari i Përgjithshëm	1	I-2
IV. Inspektor		
Inspektor	28	I-4
Ndihmës Inspektor	12	II-1
V. Drejtoria Juridike dhe e Marrëdhënieve me Institucionet		
Drejtor	1	II-1
V/1. Sektori i Marrëdhënieve me Autoritetet		
Përgjegjës sektori	1	III-1
Specialistë	3	IV-1
V/2. Sektori i Këshillimit Juridik		
Specialist	2	IV-1
VI. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë		
Drejtor	1	II-1
VI/1. Sektori i Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Infrastrukturës		
Përgjegjës	1	III-1
Specialist	3	IV-1
VII. Drejtoria e Financës dhe Administrimit		
Drejtor	1	II-1
VII/1. Sektori i Protokoll-Arkivit dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurisë		
Përgjegjës sektori	1	III-1
Specialist	5	IV-1
VII/2. Sektori i Administrimit të Financë-Buxhet		
Përgjegjës sektori	1	III-1
Specialist finance	1	IV-1
Specialist buxheti	1	IV-1
Magazinier	1	V
Shofer	2	III
Recepsionist	1	II
Punonjës Pastrimi	2	I
Gjithsej	**73 punonjës**	